



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 78/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.02.2018, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr.248 prot., dt.14.02.2018 për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-39671-12-29-2017, me objekt: Loti i Tretë “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi i rrugëve “Migjeni” dhe “Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar – Faza I”, me fond limit 1,931,794 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 15.01.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues:

“C.E.C Group” shpk
Rruga “Dritan Hoxha”, Nd.17,Shk.2, Ap.5/3 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia e Tiranës
Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë,
Shqipëri.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.12.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF-39671-12-29-2017, me objekt: Loti i Tretë “*Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi i rrugëve “Migjeni” dhe “Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar – Faza I*”, me fond limit 1,931,794 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 15.01.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 15.01.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 19.01.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.4. Në datën 29.01.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5. Në datën 09.02.2018 operatori ekonomik ankimues është vënë në dijeni nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën nr.4121/2 datë 05.02.2018 lidhur me mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 14.02.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 16.02.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik kërkesën me nr.248/2 prot me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-39671-12-29-2017, me objekt: Loti i Tretë “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi i rrugëve “Migjeni” dhe “Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar – Faza I”, me fond limit 1,931,794 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 15.01.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “C.E.C Group” sh.p.k për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-39671-12-29-2017, me objekt: Loti i Tretë “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi i rrugëve “Migjeni” dhe “Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar – Faza I”, me fond limit 1,931,794 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 15.01.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “ Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos

shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Sa mësipër në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF-39671-12-29-2017, me objekt: Loti i Tretë “*Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi i rrugëve “Migjeni” dhe “Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar – Faza I*”, me fond limit 1,931,794 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 15.01.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 248/2 Protokoll; Datë 16.02.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha